



## KUVENDI

### Ekstrakt

**nga procesverbali i mbajtur më 18 tetor 2016, në mbledhjen e XXXIII-të (tridhjetetë) - e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës.**

Mbledhja filloi në orën 10:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z.Xhevdet Beselica, për të cilin Kryesuesi i Kuvendit tha se mungon me arsye për shkak të një vizite shëndetësore, arsyetim i paraqitur në formë të shkruar.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë, kjo është mbledhje urgjente mirëpo edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa jemi pajtuar që të bëhet zëvendësimi i ish këshilltares znj.Mrika Thaqi tani e emëruar drejtoresh në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përkatësisht të bëhet betimi i anëtares së re të Kuvendit znj.Tringa Sfishta sipas Vendimit për certifikimin e të përmendurës nga Komisionit Qendror Zgjedhor nr.803/2016 të datës 13 tetor 2016. Pra kërkoj mirëkuptim nga ana e këshilltarëve të Kuvendit, dhe nëse pajtoheni ftoj Komisionin për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës të bënë verifikimin e mandatit të të përmendurës, dhe njëkohësisht të paraqesë raportin verifikues.

*Njëzëri u pajtuan këshilltarët e Kuvendit që të procedohet me dhënien e betimit të këshilltares znj.Tringa Sfishta, dhe njëkohësisht të vazhdohet me punë sipas thirrjes së kësaj mbledhjeje dhe rekomandimit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.*

Kryesuesi i Kuvendit fton anëtarët e Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës, z.Bahri Blakqori, z.Flakron Gashi dhe z.Haki Rudari, të bëjë verifikimin e mandatit të këshilltares se cekur.

### Raporti i Komisionit verifikues.

**z.Flakron Gashi**, Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit, ka konstatuar se zëvendësimi i këshilltares znj.Mrika Thaqi është bërë në pajtim me ligjin për zgjedhjet lokale dhe rregullat tjera të Kuvendit të Komunës me këshilltaren nga radhët e AAK-LDD znj.Tringa Sfishta e cila tani e tutje do të jetë anëtare e rregullt me të gjitha të drejtat e plota të Kuvendit të Komunës së Podujevës. Në emër të komisionit, të përmendurës i urojmë punë të mbarë dhe suksese.

Kryesuesi i Kuvendit z.Mehmet Gashi, theksoi, në bazë të Vendimit të KQZ-së nr.803/2016 të datës 13 tetor 2016, dhe Raportit të Komisionit për verifikimin e mandateve të këshilltarëve të Kuvendit, ftoj znj.Tringa Sfishta të bënë Betimin solemn.

*Pas përfundimit të procedurave të dhënies së betimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se nga tani zyrtarisht znj.Tringa Sfishta është këshilltare e Kuvendit të Komunës së Podujevës dhe njëkohësisht e uron këshilltaren për mandatin.*

➤ **Propozimi i Vendimit për rialokimin e një pjese të mjeteve buxhetore të Komunës së Podujevës në vitin 2016**

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, fillimisht fjalën hyrëse do të paraqes z.Isuf Latifi, drejtor i drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

**z.Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe financave (DBF) e paraqiti fjalën e hyrjes, ndër të tjera theksoi, rialokimi ose rregullimi i buxhetit të Komunës për vitin 2016 bëhet për shkak se në disa projekte ka tepricë të mjeteve buxhetore ndërsa në disa projekte tjera ka mungesë të mjeteve, andaj me këtë rialokim krijohen kushte që të gjitha kontratat të jenë të balancuara dhe të kenë mjete të mjaftueshme në mënyrë që për punët ekzekutore të kryhen pagesat përkatëse..

**z.Fidan Rekalii**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim rialokimin e mjeteve buxhetore për vitin 2016. Shfrytëzoj rastin që këshilltares së re znj.Tringa Sfishta i uroj suksese dhe punë të mbarë.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, fillimisht ju uroj punë të mbarë drejtoreshës së re të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit znj.Mrika Thaçi dhe drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik z.Ejup Visoka, ndërsa znj.Tringa Sfishta i urojmë punë të mbarë dhe një bashkëpunim të mirë. Në mbledhjen e KPF-së jemi pajtuar se kjo mbledhje është e jashtëzakonshme, pra është një obligim i mundshëm ligjor për rialokim të mjeteve. Ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së mendojmë se nuk ka qen një planifikim ekzakt për arsye se ka mjete deri në 50% të parapara. Në fushën e shëndetësisë një projekt prej 100,000.00 € ka mbet suficit prej 50,000.00 € sa janë paraparë për aparatën e mamografisë, kërkesa është që në të ardhmen projektet mos ta kalojnë përqindjen e paraparë ligjore, përndryshe për këtë rialokim të buxhetit ne si Grup i këshilltarëve do të abstenojmë, jo për qëllime të natyrës politike por me qëllimin që Drejtoritë e Komunës në të ardhmen planifikimet t'i bëjnë më të përafërta me buxhetin e Komunës.

Edhe pse është seancë e jashtëzakonshme dhe ne duhet t'i përmbahemi rendit të ditës, dua të theksoj se në mbledhjen e kaluar nga Kryetari i Komunës z.Agim Veliu ka mbet që të thirren shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit për të diskutuar rreth çështjes së Obeliskut "Afrim Zhitia", mirëpo nuk jemi ftuar ende, andaj meqë prezent këtu është Nënkryetari i Komunës z.Nexhmi Rudari kërkoj ta njoftoj Kryetarin e Komunës pasi që kjo është një kërkesë, dhe me qëllim që të marrim një qëndrim të përbashkët.

**z.Haki Rudari**, theksoi, uroj këshilltaren e porsazgjedhur si dhe drejtoreshë e re të DKRS-së dhe drejtorin e DPZHE. Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së ka analizuar dokumentin e propozuar për rialokimin e mjeteve dhe kemi ardhur në përfundim se këtu janë dy çështje që vlen të theksohen. E para, vazhdimisht po përsëritet rialokimi i mjeteve dhe kjo tani përkon me atë që ne vazhdimisht e kemi thënë se mungon një program qeverisës i saktë dhe i kompletuar dhe kjo po vërehet, po shihet dhe po vazhdohet, ndërsa vërejtja e dytë qëndron në anën teknike të rialokimit të mjeteve, prap vazhdohet me atë të vjetrën, pa specifikim, vetëm arsyetim në kuptimin matematikor. Nuk është mirë të kemi vetëm një shumë të mjeteve, por duhet të specifikohen se

ku shkojnë ato mjete, në mënyrë që ne si këshilltarë kur të dalim në takim me qytetarë të dalim më të saktë dhe decidiv me atë që themi sepse fundja për ata kemi marrë votata e jo të ndodh sikurse rasti i shkollën në fshatin Balloc ku pas fillimit të mësimet shkollës i hiqet kulmi dhe fillon të punohet ku jo vetëm për pozitën por edhe ne si opozitë nuk ndihemi mirë nga zhvillime të tilla.

Në vazhdim dëshiroj të cekë disa nga vërejtjet që i kemi evidentuar ne si Grup, në radhë të parë nuk pajtohem ngase merren mjete nga vendet në të cilat duhet të investohen, shembull nga projekti në fshatin Herticë – Surdull, merren mjete në vend se të bëhen investime që do të ndikonte në parandalimit të migrimit të popullatës, fshat i cili nga viti në vit kjo është duke u përsëritur sa i përket investimeve ku herë qiten mjete e herë hiqen. Pastaj asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Konushec kodi 40327 shuma 2,313.00 € mendoj se është qesharake kjo shumë, gjatë vizitës që i kam bërë ati fshati jam takuar me banorët e asaj lagjeje dhe aty është bërë një asfaltim në mënyrë jo të drejtë ngase lagjja e cila ka pas projektin nuk është asfaltuar fare, kurse lagjja tjetër edhe pse ndoshta nuk ka pas projekt është asfaltuar edhe pse në parim e përkrah asfaltimin kudo që ndodhë. Nëse shikojmë dokumentin e rialokimit, prap kemi koncentrim të rialokimit të mjeteve në dy-tri vende që vazhdimisht po përsëriten. Çështje tjetër është tek ndërtimi i urave, prap kemi ndërtim të urave pa pasur specifikim ku dhe si, çështje tjetër për të cilën mendojmë se është mirë të marrim përgjigje është pajisjet mjekësore kodi 48137 shuma 42,507.00 €, mendoj se përveqë shumë që është barazim matematikor është mirë ne si këshilltarë t'i kemi të specifikuara se ku janë këto. Renovimi i objekteve shëndetësore dhe ndërtimi i objekteve ndihmëse për QKMF-në dhe AMF-të, nuk është mirë që të rialokohen 30,000 - 40,000 për ndërtimin të shupave.

Zgjerimi i sallës së teatrit kodi 40355 shuma 49,000,00 €, ne edhe më parë kemi dhënë vërejtje dhe tani rezulton se vërejtja jonë ka qenë e arsyeshme, pra këto mjete tani shkojnë për sport dhe rekreacion andaj është mirë që speciofikohet kjo dhe nuk e di pse kjo po përsëritet kjo vazhdimisht. Sa i përket ridestinimit të mjeteve nga të hyrat vetanake, në mbledhjen e djeshme të KPF-së e kam ngritur një çështje të cilën pasi kam shkuar në shtëpi e kam vërtetuar se është kërkesë e banorëve të dy lagjeve në fshatin Shajkoc për shkak të daljes së ujërave të zeza në sipërfaqe dhe ata nuk janë në gjendje të qëndrojnë aty, prandaj mendoj se është mirë që përmes këtij rialokimi kjo çështje të parashihet sepse është kërkesë e theksuar e atyre banorëve. Çështje tjetër është pastrimi dhe zgjerimi i shtratit të lumenjve, shuma 13,400.00 €, është mirë të dimë se për cilët lumenj bëhet fjalë, si do që të jetë ne përkrahim punën kudo që bëhet nëpër lumenj, por është mira ta dimë se në cilën pjesë të lumenjve destinohen ato investime. Si përfundim mund të marrim ku ne si rialokimin e përkrahim në parim, por megjithatë këtë formë të rialokimit dhe këto kode ku merren dhe ku shkojnë, Grupi i këshilltarëve të LVV-së do të voton kundër.

**z.Fidan Rekalio**, theksoi, desha të jap një sqarim sa i përket tërheqjes së mjeteve nga projekti për ndërtimin e rrugës Herticë - Surdull. Ne si Ministri e Infrastrukturës jemi afër marrëveshjes me Komunën për të investuar projektin në fjalë për hirë që është një shumë e madhe e mjeteve buxhetore të cilën buxheti i Komunës nuk mund ta përballoj ngase është projekt me një gjatësi të madhe. Prandaj Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Podujevës janë afër nënshkrimit të një marrëveshjeje për realizimin e atij projekti, marrëveshjeje e cila bëhet me qëllim të plotësimit të buxhetit të Komunës së Podujevës për realizim të projekteve në hapësira tjera.

**znj.Adelina Stublla**, theksoi, nuk dëshiroj të ndalem në detaje të kodeve, por dëshiroj të bëjë një pyetje, pse të teprojnë mjete buxhetore kur dihet se që tri vite radhazi ne opozita kemi ngritur çështje në të mirë që qytetarëve, çështje të cilat nuk kanë kosto të lartë të vlerës por përgjigja nga ana juaj ka qenë se nuk kemi buxhet, pra kjo i bie se ka menaxhim të dobët nga ana e drejtorëve të Drejtorive përkatëse apo Ekzekutivit në përgjithësi, e tash këto mjete të tepruara i keni dedikuar si zakonisht në asfalte. Kërkesat tona nuk janë për ne por në të mirë të qytetarëve.

Marrim shembull rastin e Malishevës që kishte realizuar kërkesën e opozitës, gjegjësisht të LVV-së për realizimin e shujtës së nxënësve nëpër shkolla, e ne si duket këtu çështjet vetëm po i ngritim së koti, shembull, që tri vite është kërkuar stimulimi i lehonave ku në vitin 2014 kanë qenë vetëm 74 lindje, pastaj kontrollat mjekësore në çerdhe dhe në shkolla, rregullimi i oborrit të çerdes e cila nuk ngjason në çerdhe por duket vetëm si një objekt dhe asgjë tjetër, pastaj mungesa e mirëmbajtjes së ndriçimit publik apo mos vendosja fare në disa lagje të qytetit ku kjo parqet një rrezik permanent për nxënësit të cilët fillojnë mësimin në ora 15:00 në mungesë të klasave siç është rasti i SHFMU "Naim Frashëri" që mungojnë 9 klasë, mandej rasti tjetër është i urës së qytetit, që tre muaj është filluar me ndërtimin e urës me një kosto gogja të lartë dhe ende nuk ka përfunduar e që është diçka e palogjikshme sepse nuk po ndërtohet pallat por kemi të bëjmë me ndërtimin e një ure.

**z.Fidan Rekalii**, theksoi, pyetje për këshilltaren parafolëse, a ka mundësi të na tregoni se cili projekt i Komunës së Podujevës nuk është i realizuar për interesa të qytetarëve të Komunës.

**z.Haki Rudari**, theksoi, këshilltari parafolës paraprakisht parashtroi pyetje, mirëpo i njëjti në sqarimin e tij rreth rrugës Herticë - Surdull nuk e tha se është nënshkruar marrëveshja, por e tha se jemi afër, unë mendoj se në mes nënshkrimit dhe afër, është një dallim shumë i madh, kjo është vetëm sa për t'i hedhur hi syve banorëve në mënyrë që në vitin e ardhshëm meqë janë zgjedhjet, pra më shumë është përgatitje për vitin e ardhshëm për projekte. Sa i përket projekteve ne vazhdimisht kemi thënë se të gjitha projektet kudo që realizohen në parim i përkrahim, por nuk i përkrahim investimet politike që vijnë apo shkojnë ku janë zyrtarë të LDK-së, nuk i përkrahim subvencionimet që i bëhen kryesisht njerëzve të LDK-së, nuk e përkrahim ndarjen e bursave që i bëhet kryesisht njerëzve dhe të afërmve të LDK-së. Kundër këtyre është Grupi i këshilltarëve të LVV dhe vazhdimisht do të jemi kundër këtyre. Çështje tjetër është pse nuk thirreni asnjëherë në rregulloret kur bëhet ndarja e bursave, e vetmja Komuna që bënë ndarjen e bursave pa një rregullore të posaçme është Komuna e Podujevës. I kam dy rregullore të dy komunave, një të LDK-ja dhe tjetrën PDK-ja, komplet ndarja e bursave dhe subvencioneve bëhet nga një komision ku janë përfaqësues edhe këshilltarët e kuvendit komunal, e vetmja Komuna e Podujevës nuk e bënë këtë.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, nënvizoi, sot në rend të ditës kemi pikën ose temën për rialokimin e një pjese të mjeteve buxhetore të Komunës së Podujevës për vitin 2016, andaj kërkoj të mos të kalojmë me diskutime jashtë rendit të ditës. Nëse nuk ka këshilltarë tjerë për të diskutuar, fjalën ua japim drejtorëve të Drejtorive.

**z.Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), theksoi, brenda kornizës ligjore kemi paraqitur propozimin e rialokimit të mjeteve buxhetore, po të mos kishte nevojë për rialokim as me dispozita ligjore nuk do të ishte paraparë kjo çështje, çdo organizatë buxhetore apo institucion bënë rialokime të këtyra duke zbatuar dispozitën ligjore që rialokimi të bëhet deri në 15%. Propozimin për rialokim që ne e kemi paraparë për këtë vit është shumë i vogël madje shumë i vogël edhe në krahasim me vitet e kaluar gjë e cila nënkupton se kemi planifikime shumë më të sakta dhe se asnjëherë planifikimet nuk mund të jenë në sasinë e plotë, sepse ajo rregullohet vetëm me ligjin e tregut. Prandaj nëse nga 1,285,000.00 € grant, rialokohen 33,000.00 €, do të thotë është një shumë 2.58%, dhe nga të gjitha ato janë katër kontrata të cilat janë të nënshkruara kanë përfunduar punët dhe ka tepërisht të mjeteve. Përse ato mjete të mbeten suficit kur nevojat për Komunën janë të shumta për realizime të projekteve të ndryshme, prandaj bëhet rialokimi dhe gjithëherë ato mjete shkojnë në ato projekte të cilat janë të miratuara ose që janë projekte dy vjeçare që kanë mundësi për plotësim të buxhetit. Sa i përket asaj që u tha se nuk specifikohen projektet, e them se rialokimet bëhet brenda kodeve të cilat

janë miratuar. Sa për sqarim janë tri projekte duke u kryer rreth zgjerimit të lumenjve, projekt i veçantë zgjerimi i shtratit të lumit Llap nga lagja Pireva deri te ura që shkon për fshatin Majac që është një projekt i veçantë, projekti i dytë është zgjerimi i lumit Llap në drejtim Lluzhan – Shakovicë deri në fshatin Llugë, dhe projekti i tretë që është edhe me këtë rialokim, zgjerimi i lumenjve në fshatrat Dumnicë, Llaushë, Peran. Te fshati Shajkoc kanalizim nuk kanë lagja Sinani, aty janë në pyetje derdhjet e tërë fshatit dhe kërkesë e tyre dhe ne kemi shikuar zgjerimin e lumit ku bëhet derdhja e ujërave nga fshati Shajkoc deri në lagjen Sinani 1.1 km, zgjerimin do ta bëjmë vitin e ardhshëm dhe aty përveç zgjerimit është edhe rregullimi – vazhdimi i kanalizimit. Prandaj me atë buxhet është e pamundur me bërë atë ndryshim. Sa i përket ndriçimit publik, fjala është për ndriçim të ri, është e vërtetë se kemi lagje dhe fshatra pa ndriçim, por vetëm në këtë vit është vetëm një projekt me 5850 m gjatësi që në përfundim e sipër, projekti i dytë është rruga “Nazim Gafurri” me rrugët tjera Ismajl Qemali dhe Sali Çitaku, në gjatësi 3770 m, projekt ky i cili përfshihet me këtë rialokim me qëllim të plotësimit të asaj kontrate. Shpresoj të miratohet ky propozim sepse me këtë zvogëlohet bukur shumë suficitin i eventual dhe plotëson bukur shumë deficitin.

**z.Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUMM), theksoi, drejtori parafolës veç se arsyetoi nevojën dhe bazueshmërinë e rialokimit të mjeteve buxhetore. Unë do të ndalem në dy pyetjet e parashtruara nga këshilltarët e LVV rreth projektit të rrugës Herticë-Surdull dhe në fshatin Kunushec rreth një rruge me një shumë të mjeteve mbi 2,000.00 €, pra kjo shumë e mjeteve është mungesë që është bërë nga kontrata. Sa i përket projekti për asfaltimin e rrugës Herticë-Surdull, këshilltari z.Fidan Rekaliu dha një sqarim se ne kemi pas disa konsultime me Ministrinë e Infrastrukturës ku edhe na kanë premtuar se vitin e ardhshëm do të ndajnë mjete për asfaltimin e asaj rruge. Gjithashtu dëshiroj të plotësoj diçka edhe sa i përket një projekt i cili është dorëzuar që rreth 1 vit e gjysmë përkatësisht rruga e cila lidhet nga fshati Herticë në drejtim të rrugës së Shajkocit në të cilën vitin e kaluar kemi intervenuar me një shumë 10,000.00 € për pastrim të terrenit ndërsa tani jemi duke bërë hartimin e projektit, kështu që kemi menduar që mjetet t'i bartim nga Memorandumi i nënshkruar mes Kryetarit të Komunës dhe Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës. Ndërsa për fshatin Konushec kemi edhe disa projekte tjera të dorëzuara nga komuniteti i asaj ane të cilat ende nuk kemi mund t'i realizojmë edhe pse ai fshat është bukur shumë i përmbyllur me asfaltim. Ju garantoj publikisht se asnjë projekt i cili i është proceduar me kërkesë në DPUMM-së nuk është duke u zhvilluar pa projekt zbatues, dhe të gjitha rrugët e përfunduara në fshatin Konushec të gjitha kanë projekte zbatuese, dhe secilit që i intereson diçka rreth këtyre çështjeve lirshëm mund të vijë në zyrë dhe të shoh dokumentacionet përkatëse apo edhe mund të bëjmë vizita në terren për të analizuar ato projekte.

**z.Bahri Selimi**, theksoi, përgjigjet e disa drejtorëve të Drejtorive më bën përshtypje të marr fjalën. E kemi parasysh se rialokimi është i paraparë me ligj dhe për ata edhe duhet të bëhet, mirëpo drejtori i DSHPMSh theksoi se me ligj është paraparë që rialokimi i mjeteve buxhetore të bëhet deri në 15%, do të thotë se gjithçka deri në këtë përqindje po konsiderojmë se është legjitime dhe e drejtë, por kur është bërë rialokimi prej 48% apo 29% tjetri, nuk jam në dijeni se për çfarë rialokimi e kemi fjalën, kjo a është apo jo e ligjshme, fjala është për blerjen e mamografit, shuma e ndarë prej 105,000 € do të thotë se vetëm paska qenë vetëm ashtu, sa për sy e faqe, përderisa ai është blerë në shumë prej 50,000 €, pra ose është bërë ndarja e buxhetit pa marr paraprakisht asnjë ofertë nga ana e shitësve, ose është ndarje me qëllim që të teprojnë mjete për të realizuar ndonjë projekt ndonjë qytetari që është drejtuar më herët për t'ia plotësuar ndonjë kërkesë, si dhe çështja tjetër, për zgjerimin dhe renovimin e sallës së kulturës kanë qenë të parapara afro 166,000.00 € dhe këtu kanë tepruar 49,000.00 €, e që i bie se 29% të mjeteve janë të tepruara

dhe të propozuara për rialokim, do të thotë në këto dy projekte, mund të përfundojmë se qenkan në kundërshtim me ligjin për rialokimin e mjeteve buxhetore.

**z.Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF), theksoi, dëshiroj të jap një sqarim rreth përqindjeve të lejuara të mjeteve të propozuara për rialokim. Unë edhe në fjalën hyrëse e ceka se Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë neni 30.2 e saktëson deri në cilën përqindje ne si organizatë buxhetore mund të kemi lëvizje, jo projekt për projekt, por si organizatë buxhetore, pra decidivisht thuhet, Ministri i Ministrisë së Financave ka të drejtë të miratoj kërkesën e një udhëheqësi të një organizate buxhetor nëse është në kuadër të përqindjes deri në 15 %. Pra kërkesën tonë deri në 15% që sot është sjellë për miratim në Kuvend, Ministri e miraton automatikisht, mirëpo nëse tejkalohej përqindja pre 15% - 25%, vendimin e Kuvendit komunal e aprovon Qeveria e Republikës së Kosovës sipas nenit 30 të ligjit të cekur, ndërsa nëse tejkalohej përqindja mbi 25% atëherë ai vendim i Kuvendit komunal duhet të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës ku nëse miratohet ai vendim bëhet ligj. Ne e kemi fjalën për një përqindje prej 6.2% si organizatë buxhetore me të cilën e plotësojmë kushtin që Ministri i Ministrisë së Financave automatikisht ta miratoj me arsyetimet shitesë që ne i japim, ku për secilin projekt që kemi theksuar se do t'i hiqen mjetet jemi të obliguar të dërgojmë kopjen e kontratës. Pra neve na duhet të specifikojmë sa i përket tepricës së mjeteve nga kontrata përkatëse duke specifikuar edhe rialokimin e mjeteve në kontratën e cila ka mungesë të mjeteve buxhetore, do të thotë duhet të jepen sqarime konkrete për secilën kontratë veç e veç. Pra jemi në kuadër të dispozitave ligjore ku rialokimi nuk e tejkalon 15% të buxhetit dhe si organizatë buxhetore kemi të drejtë të bëjmë lëvizje të buxhetit me miratim të Ministrit të Ministrisë së Financave.

**z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, u diskutua dhe u arsyetua nevoja dhe mundësitë ligjore për rialokimin e mjeteve buxhetore. Ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë propozim vendim dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim duke pas parasysh se është interes i përgjithshëm i Komunës së Podujevës. Jeni në dijeni se me procedura të prokurimit është e pamundur të parashihen saktësisht mjetet buxhetore për një projekt, andaj siç u theksua në disa projekte ka tepricë të mjeteve kurse në disa projekte tjera ka mungesë të mjeteve andaj duhet të plotësohen dhe barazohen kontratat ose në të kundërtën ato mjete mund të mbetet suficid, andaj e hedhë në votim këtë propozim vendim.

*Pas votimit u konstatua se me 20 vota për, 4 vota kundër dhe 9 vota të përmbajtura u miratua propozim Vendimi për rialokimin e një pjese të mjeteve buxhetore të Komunës së Podujevës për vitin 2016.*

Në vazhdim, **Kryesuesi i Kuvendit**, i njoftoj këshilltarët e Kuvendit rreth kërkesës së miratuar në mbledhjen e kaluar për realizimin e një vizite në qytetin e Sarandës në Republikën e Shqipërisë, dhe agjendën e takimit dhe njëkohësisht kërkoi secili nga këshilltarët të konfirmoj pjesëmarrjen në këtë vizitë.

**Mbledhja përfundoi në orën 10:45**

**Procesverbalin e mbajti**  
**Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-79976**  
**Podujevë,**  
**18 tetor 2016**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Mehmet Gashi**